

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“GREEN GRAPHICS STUDIO” SH.P.K**

Sot, me date 11/01/2021 (dymije e njezete e nje), ishte prezent personalisht ortaku themelues:

- **Sabri Osma**, shtetas shqipetar, i biri i Bashkim dhe Shpresa, lindur me 13.04.1978, ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal H80413059P, banues ne adresen Rr. e “Elbasanit”, Nr. 373/1, Tirane, Shqiperi, e cili ka vendosur te themeloje shoqërinë tregtare “**GREEN GRAPHICS STUDIO**” SH.P.K, me kushtet si më poshtë:

NENI 1
Statusi Juridik

Shoqëria Tregtare “**GREEN GRAPHICS STUDIO**” SH.P.K është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2
Emri i shoqërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “**GREEN GRAPHICS STUDIO**” SH.P.K.

NENI 3
Objekti i veprimitarise

Objekti i Veprimitarise së Shoqërisë përfshin por nuk kufizohet në:

- Studime, projekte dhe zbatime ne fushen e pyjeve dhe kullotave;
- Studime, projekte dhe zbatime ne fushen e mjedisit, bujqesise, sociale, ekonomike, territorit, infrastrukturies etj.;
- Vleresime te ndikimit ne mjedis;
- Studime dhe projekte ne fushen e gjelberimit urban;
- Studime pedologjike, te flores dhe faunes;
- Kontroll dhe supervizim punimesh;
- Sherbime konsulencë dhe ekspertize;
- Vleresim te pasurive te paluajteshme.

Sabri Osma



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet, në adresën: Rr. "Marko Bocari, Pallati "TID", Shkalla 1, Apartamenti 3, Tirane, Shqipëri

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i investuar nga ortaket, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100 000 (njeqind mijë) Lek, i ndare në 1 (një) kuote me vlerë nominale të një kuote prej 100 000 (njeqind mijë) Lek.

Sabri Osma zotëron 1 (një) kuote me vlerë te pergjithshme 100 000 (njeqind mijë) Lek që perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total.

NENI 6
Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqerise në Regjistrin Tregtar.

NENI 7
Organet Drejtuese

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqerisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund te zgjidhen për një afat deri ne pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "**GREEN GRAPHICS STUDIO**" Sh.p.k, eshte z. **Sabri Osma**, shtetas shqiptar, i biri i Bashkim dhe Shpresa, lindur me 13.04.1978, ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal H80413059P, banues ne adresen Rr. e "Elbasanit", Nr. 373/1, Tirane, Shqipëri, i cili zgjidhet per një periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritjeje.



Shoqeria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo cdo entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8
Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortaku Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

NENI 10
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhen shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE

“GREEN GRAPHICS STUDIO” SH.P.K

Sabri Osma

Sabri Osma
